



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 nëntor 2014
Nr. ref.:RK730/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI110/14

Parashtrues

Sokol Stavileci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014

GJYKATA KUSHTEUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sokol Stavileci, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston njoftimin Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014. Parashtruesi, gjithashtu kërkon përmbarimin e Aktvendimit Nr. 435/84 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 25 shkurtit 1988.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit Nr. 254 të Bankës Qendrore të Kosovës, të 14 prillit 2014, nëpërmjet të cilit iu refuzua shqyrtimi për kompensimin e dëmit që parashtruesi i kërkesës e kishte pësuar në aksident trafiku në vitin 1981, për çka ai pretendon se *“i janë shkelur shumë rëndë të drejtat kushtetuese”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 korrik 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI110/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI110/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 1 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në vitin 1981, parashtruesi i kërkesës kishte pësuar aksident trafiku.
10. Gjatë viteve 1981 dhe 1983, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar kompensim për dëmin material dhe jomaterial nga BS “Kosova” në Gjakovë dhe në Prishtinë.
11. Në vitin 1984, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur padi ndaj BS “Kosova” në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
12. Më 25 shkurt 1988, Gjykata e Qarkut në Pejë kishte vendosur përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.

13. Më 11 prill 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Bankën Qendrore të Kosovës.
14. Më 14 prill 2014, Banka Qendrore e Kosovës ishte përgjigjur: *“Pasi kemi pranuar ankesën tuaj të datës 11.04.2014 Banka Qendrore e Kosovës, ju njofton se nuk është kompetente në shqyrtimin e rastit tuaj përkatësisht nuk është kompetente për shqyrtimin e lëndëve të cilat lidhen me kompanitë që kanë funksionuar para themelimit të BQK-së”*.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës kërkon përmbarimin e Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (Nr. 435/84, të 25 shkurtit 1988) përkitazi me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.
16. Parashtruesi nuk përmend shkeljen e ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, mirëpo pretendon se *“të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur rëndë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të gjykoj kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:
“Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
19. Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës që parasheh:
(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]
c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.
20. Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36 (2) b) d) të Rregullores së punës që parasheh:
(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;
[...]
d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se cilat të drejta janë përcaktuar me Njoftimin (Nr. 254, të 14 prillit 2014) të Bankës Qendrore të Kosovës dhe as nuk ka treguar se pse dhe si ato të drejta janë cenuar nga Njoftimi i kontestuar. Prandaj, Njoftimi në fjalë nuk mund të konsiderohet si një akt i kontestuar në këtë Gjykatë siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.
22. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për përmbarim të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë (Nr. 435/84, të 25 shkurtit 1988), Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka treguar se ka kërkuar zhvillimin e procedurave të përmbarimit tek gjykatat e rregullta; për më tepër, vendimi në fjalë është nxjerrë në vitin 1988 çka është jashtë juridiksionit kohor të Gjykatës dhe rrjedhimisht *ratione temporis* i papajtueshëm sepse Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.
23. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se kërkesa është *prima facie* e paarsyetuar për shkak se parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimet e tij në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë dhe më tej të specifikuar në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) b) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) b) d) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani

